



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 28 janar 2019

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së datës 28 janar 2019-KPK/Nr.60/2019, shpall:

RISHPALLJE E BRENDSHME

- I. Për plotësim me tri (3) pozita për prokurorë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
- II. Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:
 1. Të plotësojë kushtet për të punuar si prokurorë në Departamentin për Krime të Rënda, si dhe të ketë vlerësimin pozitiv të performancës;
 2. Të kenë mandat të përhershëm;
 3. Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përveç qortimit.
 4. Pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me procedurën penale, mjetet juridike, praktikat juridike të gjykatave vendore dhe ndërkombëtare do të merret parasysh.
- III. Kandidati që parashtron kërkesë duhet të dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:
 1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
 3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektiviisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

- IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë për avancim.
- V. Kandidatët të cilët kanë aplikuar në shpalljen e parë ju njihet e drejta e aplikimit dhe ata nuk kanë nevojë që të aplikojnë përsëri për pozitat që kanë aplikuar.
- VI. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 28 janar 2019 deri më datë 11 shkurt 2019.
- VII. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e parë (1) të ish ndërtesës së EULEX-it, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 18, të mbyllura në zarf, ose me postë.